



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULËS, CILËSISË DHE STATISTIKAVE
SEKTORI I SIGURIMIT TË CILËSISË

Nr. 1584/prot.
2

Durrës, më 22 / 7 /2026


Lënda: Relacion i detajuar mbi rezultatet e pyetësorit për vlerësimin e programit të studimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

REKTORIT
PROF.DR. SHKËLQIM FORTUZI

I nderuar z. Rektor,

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës" si dhe në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, Sektori i Sigurimit të Cilësisë ka zhvilluar një pyetësor, i cili ka pasur si qëllim kryesor matjen e shkallës së kënaqësisë së studentëve lidhur me strukturën e programeve të studimit, procesin e mësimdhënies, vlerësimin, shërbimet administrative dhe infrastrukturën e institucionit. Në këtë proces mori pjesë një kampion prej 110 studentësh, të cilët iu përgjigjën pyetjeve të strukturuar mbi bazën e vetëvlerësimit sasiore me pikë nga 1 deri në 5, si dhe pyetjeve të hapura për komente dhe sugjerime të lira. Pjesëmarrja kryesohet nga studentët e Fakultetit të Biznesit me 52.7%, i ndjekur nga Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike me 22.7%, si dhe Fakulteti i Edukimit me 20% të totalit të përgjigjeve, shifrat e të cilave pasqyrohen vizualisht në grafikun e parë të integruar më poshtë:


Pjesëmarrja e Studentëve sipas Fakulteteve



Për sa i përket ciklit të studimeve, 42.7% e studentëve i përkasin Programeve Profesionale 2-vjeçare,

38.2% ndjekin studimet Bachelor, ndërsa 17.3% i përkasin nivelit Master Shkencor ose Master Profesional, ku nga pikëpamja e vitit të ndjekjes së studimeve, shumica dërrmuese prej 69.7% i përkasin vitit të dytë, të ndjekur nga viti i parë me 11.9% dhe viti i tretë me 9.2%.

Në analizën e detajuar sasiore të pyetësorit, rezulton se studentët shprehin një vlerësim të përgjithshëm pozitiv sa i përket përmbajtjes dhe strukturës së programit të studimit, ku konkretisht rreth 50.9% e studentëve vlerësojnë me notën maksimale 5 faktin që objektivat e programit janë të qarta, ndërsa 22.7% e tyre e vlerësojnë këtë me pikët 4. Lidhja logjike e lëndëve është vlerësuar me pikët maksimale nga 48.2% e studentëve, teksa përditësimi i lëndëve shihet si plotësisht relevant nga 42.7% e tyre, dhe ndonëse 56.4% ndjejnë se programi kontribuon shumë në njohuritë profesionale, vlerësimi për zhvillimin e aftësive praktike ulet paksa në 49.1% për pikët maksimale, gjë që dëshmon për një nevojë të shtuar në këtë aspekt. Për sa i përket procesit të mësimdhënies, 49.1% e konsiderojnë atë shumë efektiv dhe 54.5% konfirmojnë se pedagogët inkurajojnë në mënyrë të shkëlqyer pjesëmarrjen aktive në auditor, teksa disponueshmëria e materialeve mësimore vlerësohet lart nga 45.5% e studentëve, ngarkesa akademike shihet si më e balancuar në mënyrë mesatare, ku vetëm 40% kanë dhënë vlerësimin maksimal dhe 21.8% qëndrojnë në një vlerësim neutral prej 3 pikësh. Qartësia e kritereve të vlerësimit gëzon mbështetje prej 57.3% dhe transparenca në vlerësim mbështetet nga 49.1% e studentëve, shpërndarje kjo që mund të krahasohet lehtësisht për secilën shtyllë kryesore përmes grafikut krahasimor të dytë të shfaqur më poshtë.



Megjithatë, shërbimet administrative shfaqin nevojë për rishikim, pasi vetëm 40.9% e studentëve janë plotësisht të kënaqur, ndërsa pjesa tjetër ndahet në vlerësime të shpërndara, ku rreth 32.8% e tyre japin vetëm 1 ose 2 pikë. Sa i përket infrastrukturës, sallat e mësimit vlerësohen si të përshtatshme nga 54.5%, laboratorët shfaqin hapësira për investime të mëtejshme, teksa në vlerësimin e përgjithshëm 40.9% e studentëve shprehin shumë të kënaqur me programin e tyre dhe 38.5% mendojnë se ky program i përgatit shumë mirë për tregun e punës.

Nga analiza e komenteve të hapura dhe sugjerimeve të lira, janë identifikuar qartë pikat e forta si stafi akademik për gatishmërinë dhe profesionalizmin si dhe baza e shëndoshë teorike në programet e Edukimit, Financës apo Drejtësisë, ndërkohë që si fushë kritike, kërkesë kryesore e studentëve mbetet shtimi i orëve praktike, ku kërkohet rritje e praktikave profesionale, simulimeve dhe punës direkte në terren.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E KURRIKULËS, CILËSISË DHE STATISTIKAVE
SEKTORI I SIGURIMIT TË CILËSISË

Studentët gjithashtu sugjerojnë menaxhim më të mirë të orareve dhe shërbimeve të sekretarisë si dhe ngrenë shqetësimin për procesin e vlerësimit të temave të diplomës, ku disa pretendojnë për vlerësime jo objektive nga komisionet dhe mungesë të disponueshmërisë në kohë të disa udhëheqësve. Mbi bazën e këtyre të dhënave, Sektori i Sigurimit të Cilësisë rekomandon që të ndërmerren masa konkrete për rishikimin e kurrikulave mbi orët e praktikës dhe shtimin e marrëveshjeve me institucionet dhe bizneset, hartimin e një rregulloreje më strikte për monitorimin dhe udhëheqjen e temave të diplomës që garanton transparencë, përmirësimin e sekretarive përmes digjitalizimit të shërbimeve si dhe investimin e vazhdueshëm dhe në pasurimin e bibliotekës së Universitetit.

DREJTORIA E KURRIKULAVE,
CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Znj. Pamela Luga